



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 137B Prot.,

Datë 18 . 03 .2021

VENDIM

NR. 43, DATË 18.03.2021

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESAVE DHE PËR DEKLARIMIN E PASURIVE NË USHTRIMIN E
FUNKSIONEVE PUBLIKE NGA ADMINISTRATA E AUTORITETIT TË
MEDIAVE AUDIOVIZIVE”

Në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 7, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 46, pika 1 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike nga administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA